



Me kërkesën e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, të dt.20.10.2022, për ndarjen e mjeteve financiare për kryerjen e obligimeve ndaj Marrëveshjes së Komunës me Organizatën për Zhvillim Rural(OZHR)) "Mëshqerra"-Prishtinë, participim në projektin e përbashkët nga lëmia e blegtorisë, në shumën 17,600.00 €, në mbështetje të nenit 40.2 (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 26 pika 2. të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.31.10.2022, merr këtë:

V E N D I M



PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE SI PARTICIPIM ME O.ZH.R."MËSHQERRA"-PRISHTINË NË PROJEKTIN E PËRBASHKËT NGA LËMIA E BLEGTORISË

- I. Aprovohen mjetet financiare për kryerjen e obligimeve ndaj Marrëveshjes së Komunës me Organizatën për Zhvillim Rural(OZHR)) "Mëshqerra"-Prishtinë, participim në projektin e përbashkët nga lëmia e blegtorisë, në shumën 17,600.00 €. Mjetet financiare do të derdhen në konton e Organizatës për Zhvillim Rural(OZHR)) "Mëshqerra"-Prishtinë, nr.llogarisë rrjedhëse 1501130000416395, te Raiffeisen Bank.
- II. Mjetet financiare, si në pikën I. të këtij vendimi ndahen nga linja buxhetore e Zyrës së Kryetarit shuma 7,500.00 € nga kategoria e subvencioneve dhe nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa shuma 10,100.00 € nga kategoria e subvencioneve.
- III. Për realizimin e këtij vendimi do të kujdesen: Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa e KK Deçan.
- IV. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.
- V. Me vendim njoftohen: Organizata për Zhvillim Rural(OZHR)) "Mëshqerra"-Prishtinë, Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arhivi i KK Deçan.

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

01.Nr.XIII-3

Deçan, dt.31.10.2022



Kryesuesi i Kuvendit:
Hajdar SUTAJ



Në bazë të nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008) dhe nenit 26 pika 9 të Statutit të Komunës së Deçanit 01.Nr.IX-5 të datës 31.10.2019, bazuar në Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, neni 6 pika 3.1 Dy anëtarë të komisionit të cilët propozohen nga DKA dhe miratohen nga Kuvendi i komunës, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.31.10.2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËR PËRZGJEDHJEN E DREJTORIT/ZËVENDËSDREJTORIT/ESHËS TË SHKOLLAVE NË KOMUNËN E DEÇANIT PËR VITIN SHKOLLOR 2022-2023

I.

Me këtë vendim bëhet emërimi i anëtarëve të Komisionit për përzgjedhjen e Drejtorit / Zëvendësdrejtorit/eshës të shkollave në Komunën e Deçanit, për vitin shkollor 2022/2023, në këtë përbërje:

1. Xhevat Bozhdaraj-DKA-Udhëheqës i Sektorit të Arsimit,
2. Avdyl Shala- Përfaqësues i pavarur i arsimit,
3. Një anëtar nga MASH, i cili përcaktohet nga MASH, pasi që ka marrë njoftim zyrtar, email zyrtar nga DKA.

II.

Komisioni është përgjegjës për zhvillimin e procedurës së rekrutimit të Drejtorit/zëvendësdrejtorit/eshës të shkollave në Komunën e Deçanit konform procedurave të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ(MASHT) Nr.151/2020.

III.

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria për Arsim e Komunës së Deçanit.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.


V.

Me Vendim paisen të përmendurit në pikën I. Të Vendimit, Drejtoria për Arsim, Kryetari i Komunës dhe Arhivi.

01.Nr.XIII-4

Deçan,dt.31.10.2022

	DEÇAN, OPSTINA DEÇAN REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIK E KOSOVA KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DEÇAN MUNICIPALITY
Kryetari i Kuvendit 01	90241
Nr. 01/2022 01	01.11.22
DEÇAN, DEÇANE	



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



Në bazë të dispozitave të nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (a) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), si dhe nenit 26 pika 1. të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, në harmoni me nenin 17 dhe nenin 18 paragrafi 5 të Ligjit Nr.06/L-005 për tatimin në Pronën e Paluajtshme, Kuvendi i Komunës së Deçanit pasi Rishqyrtoi Rregulloren 01.Nr.XII-3, për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023, Me kërkesën e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve të dt.24.10.2022, Nr.2246-1/2022, për shfuqizimin e aktit administrativ që është objekt i shqyrtimit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.31.10.2022, merr këtë:

V E N D I M

PËR SHFUQIZIMIN E RREGULLORES 01.NR.XII-3 TË DT.28.09.2022 PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2023

I.

Me këtë vendim bëhet SHFUQIZIMI i Rregullore 01.Nr.XII-3, dt.28.09.2022 për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023.

II.

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Deçanit.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.


IV.

Me Vendim njoftohen: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa-Zyra për tatimin në pronë dhe Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.XIII-6/1

Deçan, dt.31.10.2022

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

